



*KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.*

DIVIZIONI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

**STANDARDET E KUALITETIT TË FURNIZMIT DHE SHËRBIMIT
ME ENERGJI ELEKTRIKE PËR OPERATORIN E SISTEMIT TË SHPËRNDARJES**

Nëntor 2010

TABELA 1: STANDARDET E KUALITETIT TË FURNIZIMIT SHE SHËRBIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE PËR OPERATORIN E SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE (OSSH)

Titulli	KUALITETET MATËSE	Shënime
<p>DS1: SAIDI (Indeksi i Kohëzgjatjes së Ndërprerjeve Mesatare)</p>	<p>Indeksi i Kohëzgjatjes së Ndërprerjeve Mesatare të Sistemit (SAIDI) nënkupton kohëzgjatjen e ndërprerjeve mesatare për çdo konsumator të furnizuar, që përfshinë të gjitha ndërprerjet që rezultojnë nga ndërprerjet në sistemin e shpërndarjes. Ky indeks paraqet kohën mesatare të orëve të humbura për konsumator, si rezultat i ndërprerjeve në sistemin e shpërndarjes dhe llogaritet sipas formulës në vijim:</p> $SAIDI = \frac{\sum D_t}{\sum C_t}$ <p>Ku: D_t - paraqet kohëzgjatjen e ndërprerjeve të të gjithë konsumatorëve që ndodhin gjatë vitit t, e matur në orë/minuta. C_t - paraqet konsumatorët e shërbyer gjatë vitit kalendarik t.</p> <p>Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) do të angazhohet maksimalisht për të siguruar që vlera e SAIDI-t për vitin kalendarik 2011 nuk do të tejkalojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Njëzetë (20) orë për konsumator, sa i përket ndërprerjeve të planifikuara, ku ndërprerje të planifikuara përkufizohen ato ndërprerje që evidentohen (regjistrohen) sipas standardit të kualitetit DS5, dhe ▪ Tridhjetë (30) orë për konsumator, sa i përket ndërprerjeve të paplanifikuara, ku ndërprerje të paplanifikuara janë të gjithë ndërprerjet tjera relevante përpos ndërprerjeve të planifikuara. 	<p><u>Vërejtje:</u> <i>Plani ABC nuk merret parasysh te ky kualitet.</i></p>

Titulli	KUALITETET MATËSE	Shënime
<p>DS2: SAIFI (Indeksi i Shpeshtësisë (Frekuencës) Mesatare të Ndërprerjeve të Sistemit)</p>	<p>Indeksi i Shpeshtësisë (frekuencës) së Ndërprerjeve Mesatare të Sistemit (SAIFI) nënkupton numrin mesatar të ndërprerjeve për çdo konsumator të furnizuar, që përfshinë të gjitha ndërprerjet që rezultojnë nga ndërprerjet në sistemin e shpërndarjes. Ky indeks paraqet numrin e ndërprerjeve të konsumatorëve, si rezultat i ndërprerjeve që ndodhin në sistemin e shpërndarjes dhe llogaritet sipas formulës në vijim:</p> $SAIFI = \frac{\sum I_t}{\sum C_t}$ <p>Ku: I_t - paraqet numrin e ndërprerjeve të konsumatorëve që ndodhin në vitin t. C_t - paraqet konsumatorët e furnizuar gjatë vitit kalendarik t.</p> <p>OSSH do të angazhohet maksimalisht për të siguruar që vlera e SAIFI-t për vitin kalendarik 2011 nuk do të tejkalojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Pesë (5) ndërprerje për konsumator sa i përket ndërprerjeve të planifikuara, ku ndërprerje të planifikuara përkufizohen ato ndërprerje që evidentohen (regjistrohen) sipas standardit të kualitetit DS5 dhe ▪ Tetë (8) ndërprerje për konsumator sa i përket ndërprerjeve të paplanifikuara, ku ndërprerje të paplanifikuara janë të gjithë ndërprerjet relevante përpos ndërprerjeve të planifikuara. 	<p>Vërejtje: <i>Plani ABC nuk merret parasysh te ky kualitet.</i></p>

Titulli	KUALITETET MATËSE	Shënime
DS3: ENS (Energjia e Pa Furnizuar)	<p>Energjia e pa-furnizuar për shkak të të gjitha llojeve të ndërprerjeve që rezultojnë nga defektet në sistemin e shpërndarjes definohet si:</p> $ENS = \sum_t E_t$ <p>Ku E tregon energjinë e pa-furnizuar (EPF ose në anglisht ENS) në MWh si rezultat i çdo ndërprerje që ndodh në sistemin e shpërndarjes.</p> <p>OSSH do të angazhohet maksimalisht për të siguruar që vlera e energjisë së pa furnizuar (EPF) në vitin kalendarik 2011 nuk do të tejkalojë tetëmbëdhjetë (18) GWh.</p>	
DS4: Koha e nevojshme për rikthimin e furnizimit pas një defekti në sistemin e shpërndarjes.	<p>Në rastet kur ndërprehet furnizimi i konsumatorëve si rezultat i ndonjë defekti (ndërprerje) në sistemin e shpërndarjes, përqindja e konsumatorëve të cilëve u rikthehet furnizimi brenda numrit të orëve të specifikuar nga ndërprerja që ndodh, nuk do të jetë më e vogël se përqindjet e paraqitura më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Konsumatorët e lidhur në nivelin e tensionit 35kV: Në zonat urbane 90% e konsumatorëve do të rikyçen brenda 10 orësh; Në zonat rurale 80% e konsumatorëve do të rikyçen brenda 14 orësh; ▪ Konsumatorët e lidhur në nivelin e tensionit 10kV: Në zonat urbane 90% e konsumatorëve do të rikyçen brenda 15 orësh; Në zonat rurale 80% e konsumatorëve do të rikyçen brenda 17 orësh ▪ Konsumatorët e lidhur në nivel të tensionit 0.4kV: Në zonat urbane 90% e konsumatorëve do të rikyçen brenda 10 orësh; Në zonat rurale 80% e konsumatorëve do të rikyçen brenda 14 orësh. 	

Titulli	KUALITETET MATËSE	Shënime
<p>DS5: Periudha minimale e njoftimit për ndërprerjet e planifikuara në sistemin e shpërndarjes.</p>	<p>Në rastet që OSSH-ja bën ndërprerje të planifikuara në sistemin e shpërndarjes, ajo do të angazhohet maksimalisht për të njoftuar (informuar) konsumatorët minimum brenda 24 orësh të paktën 90% të konsumatorëve të prekur.</p> <p>Për qëllime të këtij standardi, për ndërprerjet që ndodhin në zona lokale (më të kufizuara) konsumatorët e prekur do të njoftohen nëpërmjet televizionit (TV-së) dhe radios lokale. Ndërsa për ndërprerjet që ndodhin në zona më të gjëra aty ku ndërprerja është mjaft e përhapur, konsumatorët do të njoftohen përmes një TV-je dhe një gazete nacionale, me qarkullim të gjerë ditor.</p>	
<p>DS6: Zgjidhja e ankesave që kanë të bëjnë me kualitetin e tensionit</p>	<p>Në rastet kur konsumatorët parashtrojnë ankesa lidhur me kualitetin e tensionit të furnizimit, OSSH do të angazhohet maksimalisht për të siguruar që përqindja e këtyre ankesave do të shqyrtohet dhe zgjidhet brenda periudhës së specifikuar si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. 60% e ankesave do të shqyrtohen dhe zgjidhen brenda 12 muajve, sa i përket konsumatorëve në zonat urbane; 2. 50% e ankesave do të shqyrtohen dhe zgjidhen brenda 12 muajve, sa i përket konsumatorëve në zonat rurale; dhe 3. 90% e të gjithë ankesave do të shqyrtohen dhe zgjidhen brenda 36 muajve. 	

Titulli	KUALITETET MATËSE	Shënime
DS7: Koha mesatare e përgjigjes në kërkesat e konsumatorëve të bëra përmes telefonit ose me shkrim.	<p>Në hartimin dhe zbatimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesave (pyetjeve) dhe ankesave të konsumatorëve, OSSH do të angazhohet maksimalisht për të siguruar përmbushjen e këtyre standardeve:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Koha mesatare për t'u përgjigjur ndaj thirrjeve telefonike do të jetë një (1) minutë nga momenti i ngritjes së receptorit. 2. Koha mesatare që OSSH do të përgjigjet në kërkesat e parashtruara me shkrim nga konsumatorët, do të jetë dymbëdhjetë (12) ditë kalendarik. 3. Kur kërkesat (pyetjet) telefonike dhe kërkesat (letrat) me shkrim të marra nga OSSH u takojnë përgjegjësive të një të licencuari tjetër, thirrja duhet të transferohet menjëherë te ai i licencuar ndërsa kërkesa t'i kalohet të licencuarit përkatës, mesatarisht brenda (një) 1 ditë pune pas marrjes së kërkesës; 4. Parashtruesi i kërkesës do të merr përgjigje (zgjidhje) me shkrim nga OSSH-ja për të gjitha pyetjet (kërkesat) përmes telefonit apo kërkesat me shkrim, mesatarisht brenda njëzetë (20) ditëve kalendarikë, nga e marrja e kërkesës prej OSSH-së. 	
DS8: Përgjigja në kërkesat për lidhje të reja.	<p>Në rastet që OSSH-ja merr kërkesë për lidhje të re, ajo do të angazhohet maksimalisht të siguroj që numri i kërkesave në përqindje të realizohet sipas afateve të përcaktuara si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <u>Dhënia e pëlqimit elektroenergjetik:</u> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Për lidhjet e reja në nivelin 35 kV, 10 kV, si dhe për 0,4 kV për konsumatorët industrial, pëlqimi do të jepet brenda 40 ditësh në 80% të rasteve; ▪ Për lidhjet e reja në nivelin 0,4 kV për konsumatorët jo-shtëpiakë dhe shtëpiak (komercialë dhe amvisëritë) me distancë deri në 250 metra, pëlqimi do të jepet brenda 20 ditësh në 80% të rasteve 	

Titulli	KUALITETET MATËSE	Shënime
	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Për lidhjet e reja në nivelin 0,4 kV për konsumatorët jo-shtëpiakë dhe shtëpiak me distancë deri në 35 m, pëlqimi do të jepet brenda 15 ditësh në 90% të rasteve. 2. Pranimi teknik (<u>Komisionimi</u>) kur konsumatori është përgjegjës për ndërtimin e <u>kyçjes</u>: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Veprimi i kërkuar do të realizohet brenda pesë (5) ditësh në 90% të rasteve. 3. <u>Kyçjet në rastet që OSSH është përgjegjës</u>: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Për lidhje të re në nivelet 35 kV, 10 kV dhe 0.4 kV, veprimi i kërkuar do të realizohet brenda pesë (5) ditësh. 	
DS9: Leximi i rregullt i njehsorit.	<p>OSSH-ja do të sigurojë që çdo njehsor të lexohet të paktën dymbëdhjetë (12) herë gjatë vitit kalendarik.</p> <p>OSSH do të marrë hapat e nevojshëm për të siguruar që leximet aktuale të njehsorit të merren në të paktën 95% të rasteve, kështu që përqindja e faturave të lëshuara në bazë të leximeve të përafërta (paushallë) të njehsorëve të mos tejkaloj 5% gjatë secilit muaj kalendarik.</p>	
DS10: Koha për rikyçjen e konsumatorëve pas shkyçjes për shkak të borxheve të pashlyera.	OSSH do të angazhohet maksimalisht të siguroj që koha mesatare për kryerjen e rikyçjes së konsumatorit, nga koha në të cilën merr udhëzimet për rikyçjen nga furnizuesi, nuk do të tejkalojë gjashtëmbëdhjetë (16) orë.	